KQZ
U PROTOKOLLUA
NR 5710/1 PROT
DATE 16/10 2017

**Lënda:** Dërgim Informacioni
**Drejtuar:** Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ), Tiranë,
**Nga:** **Margarita Kalemasi EKR**

Të nderuar zotërinj,

Në cilësinë e Ekspertes Kontabël të Regjistruar, bazuar në Vendimin e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve ("KQZ"), Nr. 196, datë 03.05.2017 si dhe Kontratën e Shërbimit Nr. 5484/10 Prot. datë 13.09.2017 të lidhur me ketë institucion; për të audituar fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga subjekti politik **"Partia Ora e Shqipërisë-POSH"** për vitin kalendarik 2016.

Unë fillova misionin e ngarkuar nga KQZ në datë 15.09.2017 kam dërguar shkresën prezantuese pranë subjektit politik me postë rekomnde me adresë sipas të dhënave te marra nga Regjistri i partive politike të vënë në dispozicion nga KQZ.

Nga takimi që unë pata me kryetarin e subjektit politik **"Partia Ora e Shqipërisë-POSH"**, Z. Zef Shtjefni, më deklaroi se POSH nuk ka përfituar asnjë fond nga Buxheti apo nga donatorë të tjerë për vitin kalendarik 2016.

*Si konkludim, mbështetur në pasqyrat financiare të subjektit për vitin 2016, të dorëzuara dhe të publikuara nga KQZ, si edhe në deklaratën e kryetarit (bashkangjitur),* **"Partia Ora e Shqipërisë-POSH"** *nuk ka përfituar fonde publike dhe jopublike si dhe nuk ka kryer shpenzime për fushatën zgjedhore për vitin kalendarik 2016.* ***"Partia Ora e Shqipërisë-POSH"*** *nuk ka kryer veprime nëpërmjet llogarisë bankare apo nëpërmjet arkës për këtë vit kalendarik.*

Në këto kushte unë nuk mund të realizoj misionin tim sipas kontratës së lidhur me KQZ për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjekti politik **"Partia Ora e Shqipërisë-POSH"** për vitin kalendarik 2016.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.

Eksperte Kontabël e Regjistruar
**Zj. Margarita Kalemasi**
Licensë Nr. 156, datë 08.06.2006

I.E.K.A Margarita KALEMASI
Ekspert Kontabel te Autorizuar
Licence Nr. 156

Tiranë, më 16/10/2017
Rr. Asim Vokshi,
Nd. 14, H. 6, Ap. 27,
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 42420666
Cel: +355 69 571 3335
email: m.kalemasi@joncon.al

**"Partia Ora e Shqipërisë"-POSH**
Rr. Irfan Tomini
Pallati 130, Shk. 1, Ap. 54
Pranë NSHRAK
Tiranë, Shqipëri

Tiranë, më, 09.10.2017

# DEKLARATË

**"Partia Ora e Shqipërisë",** deklaron se gjatë vitit kalendarik 2016 **NUK** ka përfituar asnjë fond publik apo privat, donacion apo sponsorizim, si dhe nga asnjë person fizikë apo juridikë.

Pasqyrat Financiare të dorëzuara në KQZ janë me zero, bazuar në pasqyrat dhe librat përmbledhës të aktivitetit financiar të përgatitura nga drejtimi sipas modeleve te aprovuara nga KQZ.

Politika e ndjekur nga ana e drejtimit është të përgatisë pasqyrat financiare mbi bazën e fondeve të përfituara dhe të realizuara gjatë periudhës ushtrimore.

**"Partia Ora e Shqipërisë",** deklaron se **NUK KA** llogari korrente ne bankat e nivelit të dytë si dhe procesverbalet e arkës janë me 0 gjatë vitit 2016.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.

**"Partia Ora e Shqipërisë"**
**Kryetari i Partisë**
**Z. Zef SHTJEFNI**